

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Pal Lekaj**

I nderuari z. Lekaj,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin tuaj të mbajtur në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Ofrimin e kredive të volitshme në bankat e Kosovës dhe ato perëndimore për afaristët dhe biznesmenët, të cilët si garant të parë do ta kenë komunën;
- Rimëkëmbjen e ekonomisë gjakovare;
- Krijimin e 7000 deri në 8000 vendeve të reja të punës për 4 vitet e ardhshme;
- Përmirësimin e pozitës së pensionistëve;
- Formimin e një zyre të posaçme për intensifikimin e zhvillimit ekonomik;
- Ofrimin e ndihmës financiare ndaj bizneseve të reja dhe rritjen e numrit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në 6000;
- Ndarjen e një buxheti prej 200,000 euro për zhvillimin e ekonomisë familjare dhe formimin e një grupi koordinues që do t'i identifikoj ekonomitë familjare që nuk janë të regjistruara;
- Rritjen e partneritetit publiko-privat;
- Rritjen e sigurisë;
- Zgjerimin e zyrës për investime të huaja dhe pasurimin e saj me profesionistë të tjerë;
- Rritjen e numrit dhe kualitetit të shkollave;
- Ndihmë për familjet e dëshmorëve, martirëve dhe invalidëve;
- Avancimin e pozitës së femrës;
- Qeverisje transparente;
- Ndërtimin e një qendre të zhvillimit të biznesit dhe një thertoreje të shpezëve, ku do të punësohen të rinj e të reja (në vitin e dytë të mandatit);
- Subvencionimin e fermave bujqësore;
- Promovimin e vlerave të Gjakovës;
- Zhvillimin e artit dhe kulturës;
- Rregullimin e rrjetit të kanalizimit dhe asfaltimin e të gjitha rrugicave të fshatit (në vitin e parë të mandatit);
- Asfaltimin e rrugës Krelan-Shqiponjë;
- Asfaltimin e rrugëve të mbetura në Rekën e Keqe (në gjashtë mujorin e parë të mandatit);
- Ndërtimin e një impianti për ujera të zeza;
- Ndërtimin e kanalizimit në fshatin Lugbunar;

- Mbylljen definitive të deponisë ekzistuese të mbeturinave brenda 5 muajve dhe zhvendosjen e saj ne Landovicë;
- Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për 24 fshatrat e Rekës së Keqe;
- Sigurimin e ujit të pijshëm dhe rregullimin dhe kompletimin e memorialit të dëshmorëve në fshatin Shqiponjë;
- Furnizimin me ujë të pijes për të gjitha fshatrat e Dushkajës;
- Mbrojtjen e mjedisit;
- Ndërtimin e rrjetit të ngrrotores në tërë bllokun e ri;
- Mirëmbajtjen e rregullt e shtratit të lumenjve;
- Ndërtimin e shtratit të lumenjve Lukac dhe Krena;
- Ndërtimin e tubave mbrojtëse në pjesët ku lumenjtë mund të paraqesin rrezik nga përmytjet apo erozioni;
- Punimin e studimit mbi rrezikshmërinë e përmytjeve dhe punimin e hartave të rrezikut;

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)